

L I G J
Nr.8136, datë 31.7.1996

PËR SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
QËLLIMI DHE DETYRAT E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 1

Krijohet Shkolla e Magjistraturës, e cila është institucion publik buxhetor dhe gëzon cilësinë e personit juridik.

Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktura në këtë ligj.

Qendra e Shkollës së Magjistraturës është në Tiranë.

Neni 2

Shkolla e Magjistraturës siguron formimin profesional të magjistratëve (gjyqtarë, prokurorë).

Formimi profesional përfshin programin formues fillestar me karakter të detyruar të kandidatëve për magistratë dhe programin për perfeksionimin në vijimësi të magjistratëve.

Shkolla e Magjistraturës, sipas dispozitave të veçanta, merr përsipër formimin profesional të punonjësve të administratës gjyqësore.

Neni 3

Të ardhurat dhe pasuria e Shkollës së Magjistraturës përbëhet:

a) nga të ardhurat që akordohen nga buxheti i shtetit; buxheti i Shkollës miratohet nga Kuvendi Popullor me propozim të Këshillit të Ministrave;

b) nga dhurimet dhe të ardhurat që sigurohen nga donatorë të ndryshëm, vendas ose të huaj të interesuar për këtë problem dhe që nuk cenojnë qëllimin dhe funksionimin e Shkollës në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) nga të ardhurat e realizuara prej shitjes së botimeve apo veprimtarive me karakter shërbimi që kryen ky institucion;

ç) nga pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme që ka në administrim;

d) nga çdo e ardhur tjetër e ligjshme.

Neni 4

Fondet, të ardhurat dhe pasuria e Shkollës së Magjistraturës i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë dhe funksionimit të saj. Këtu përfshihen:

a) pagat e personelit mësimdhënës, të specialistëve, përgjegjësve të stazheve dhe të personelit administrativ;

b) bursat e kandidatëve;

c) kryerja e punimeve apo shërbimeve, si dhe blerja e objekteve për qëllime të veprimtarisë së shkollës;

ç) veprimtari të tjera të miratura nga bordi në kuadrin e qëllimit të Shkollës.

KREU II DREJTIMI DHE ORGANIZIMI I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 5

Organet drejtuese janë:

- a) Bordi i drejtimit të Shkollës së Magjistraturës
- b) Drejtori i Shkollës
- c) Këshilli pedagogjik
- d) Këshilli disiplinor.

Neni 6

1. Bordi përbëhet nga:

- a) Kryetari i Gjykatës së Kasacionit që kryen njëkohësisht edhe detyrën e kryesuesit të Bordit dhe të mbledhjeve të tij;
- b) Prokurori i Përgjithshëm që, në mungesë të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, kryeson bordin dhe mbledhjet e tij;
- c) drejtori i Shkollës së Magjistraturës;
- d) dy gjyqtarë dhe dy prokurorë me përvojë që caktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
- e) dy specialistë me kualifikim të lartë të caktuar nga ministri i Drejtësisë dhe që kanë punuar si gjyqtarë, prokurorë ose avokatë;
- f) dekani i Fakultetit të Drejtësisë;
- g) një përgjegjës stazhi i caktuar nga drejtori i Shkollës;
- i) dy studentë të zgjedhur me votim të fshehtë nga Asambleja e kandidatëve për magjistratë, që ndjekin formimin fillestar.

Anëtarët e bordit të parashikuar në pikat d), e) dhe g) të këtij neni caktohen për një periudhë katër vjeçare dhe, me vendim të miratuar nga jo më pak se nëntë anëtarë të bordit, mund të bëhet zëvendësimi i tyre nga organet kompetente që i kanë caktuar.

2. Bordi i Drejtimit ka këto detyra:

- a) Ndjek zbatimin e kriterëve për pranimin e kandidatëve, që do të ndjekin programin e formimit fillestar.
- b) Bën seleksionimin e kandidatëve dhe vendos për pranimin e tyre për të ndjekur programin profesional.
- c) Përcakton kriteret për emërimin e trupit mësimor të shkollës dhe i emëron ato me propozim të drejtorit.
- d) Brenda buxhetit përcakton strukturën organizative dhe kriteret e emërimit të personelit administrativ.
- e) Miraton rregulloren e shkollës, formulon dhe është përgjegjës për drejtimit që do të ndjekë Shkolla.
- f) Me propozim të drejtorit përcakton planin mësimor, rregullon raportet midis lëndëve për përgatitjen e përbashkët dhe të veçantë të kandidatëve sipas profileve gjyqtarë dhe prokurorë.
- g) Propozon projekt-buxhetin e Shkollës dhe shqyrton raporte të drejtorit për realizimin e buxhetit dhe shpenzimet e të ardhurave.
- h) Paraqet çdo vit mësimor raport për Këshillin e Lartë të Drejtësisë lidhur me mbarëvajtjen dhe frekuentimin e kurseve nga magjistratët dhe kandidatët për magjistratë, si dhe për drejtimit që do të ndjekë Shkolla në të ardhmen.

3. Bordi Drejtues zhvillon jo më pak se tri mbledhje të zakonshme çdo vit, si dhe në raste të jashtëzakonshme kur thirret nga kryetari i tij.

Mbledhjet janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicë votash dhe, kur votat janë të barabarta, përcaktuese është vota e kryetarit.

4. Për mbledhjet e bordit mbahet proces-verbal nga një sekretar, ku përshkruhen edhe vendimet e bordit. Proces-verbali nënshkruhet nga kryetari i bordit dhe nga sekretari (mbajtës i proces-verbalit).

Neni 7

Drejtori i Shkollës së Magjistraturës emërohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me propozim të bordit të drejtimit nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve me kualifikim të lartë për një periudhë katërvjeçare me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

Paga e drejtorit të Shkollës është e barabartë me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Kasacionit.

Drejtori i Shkollës së Magjistraturës ka këto detyra:

1. përfaqëson Shkollën e Magjistraturës përpara organeve publike dhe private;
2. harton rregulloren e brendshme të Shkollës dhe planin vjetor të veprimtarisë të saj;
3. zbaton detyrat që burojnë nga ligjet, nga vendimet e bordit të drejtimit dhe rekomandimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

4. kërkon fonde nga shteti, donacione nga shoqata dhe individë dhe administron në mënyrë të pavarur të ardhurat, sipas drejtimeve kryesore të përcaktuara nga bordi i drejtimit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 4;

5. merr masa për publikimin e literaturës dhe të teksteve;

6. drejton trupin pedagogjik, bashkërendon punën me ta, kërkon dhe miraton programet mësimore të çdo lënde dhe kontrollon zbatimin e tyre dhe cilësinë e mësimdhënies, i propozon bordit kandidatët për pedagogë;

7. emëron dhe ka në varësi personelin administrativ dhe të gjitha veprimtaritë ndihmëse.

Drejtori ndihmohet për gjithë veprimtarinë e tij nga zëvendës drejtori, që e zëvendëson atë në mungesë apo që kryen detyrat e caktuara prej tij dhe që përgjigjet përpara tij.

Zëvendës drejtori emërohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me propozim të bordit të drejtimit. Paga e tij përcaktohet nga ky bord.

Neni 8

Drejtori, zëvendës drejtori dhe pedagogët efektivë në ushtrimin e funksionit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit.

Neni 9

1. Këshilli pedagogjik përbëhet:

- a) nga drejtori i Shkollës së Magjistraturës, i cili është dhe kryetar i tij;
- b) nga personeli mësimdhënës;
- c) nga një gjyqtar dhe nga një prokuror prej numrit të caktuar sipas gërmës d) të nenit 6 të këtij ligji, të zgjedhur me vendim të bordit.

2. Detyrat dhe funksionimi i këshillit pedagogjik përcaktohen në rregullore.

Neni 10

Këshilli pedagogjik mblidhet me kërkesën e drejtorit të Shkollës.

Mbledhjet e këshillit pedagogjik zhvillohen kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve dhe vendimet merren me shumicë votash. Kur votat janë të barabarta, përcaktuese është vota e kryetarit.

KREU III DISIPLINA

Neni 11

1. Këshilli disiplinor përbëhet:

- a) nga drejtori i Shkollës që është dhe kryetari i tij;
- b) nga një gjyqtar dhe një prokuror të caktuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë prej numrit të përcaktuar sipas gërmës d) të nenit 6 të këtij ligji, që nuk janë anëtarë të këshillit pedagogjik;
- c) nga dy pedagogë efektivë të shkollës së caktuar nga këshilli pedagogjik;

d) nga dy prej kandidatëve për magjistratë të zgjedhur çdo vit nga Asambleja e kandidatëve me votim të fshehtë.

2. Këshilli disiplinor ka kompetencë të ushtrojë funksionet e një organi disiplinor, duke marrë masa disiplinore me shkrim ndaj kandidatëve për magjistratë, që shkelin rregullat e disiplinës të përcaktuar në këtë ligj dhe në rregulloren përkatëse.

Këshilli disiplinor mblidhet me kërkesën e drejtorit të shkollës ose me paraqitjen e një kërkesë me shkrim nga personat e interesuar.

Mbledhjet e keshillit disiplinor zhvillohen kur në to marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicë votash dhe, në raste barazimi, përcaktuese është vota e Kryetarit.

Neni 12

Masat ndëshkimore janë:

1. Qortim
2. vërejtje
3. transferim nga vendi i stazhit
4. ulje page
5. përjashtim nga shkolla.

Ndëshkimet e parashikuara në pikat 1 deri 3 të këtij neni merren nga drejtori i Shkollës, kurse ato të parashikuara në pikat 4 dhe 5 nga keshilli disiplinor.

Asnjë ndëshkim nuk mund të zbatohet pa u dëgjuar më parë personi që do të ndëshkohet.

Ndëshkimet e dhëna nga drejtori mund të kundërshtohen në keshillin disiplinor.

Vendimet e keshillit disiplinor për masat e përmendur në pikat 4 dhe 5 të këtij neni mund të ankimohen në Gjykatën e Kasacionit brenda dhjetë ditëve nga dita e komunikimit të tyre. Ankimi i bërë nuk pezullon zbatimin e masës.

Masat ndëshkimore të përjashtimit nga shkolla sjellin pamundësinë për të vazhduar shkollën për pesë vjet, pa llogaritur vitin e ndërprerë.

KREU IV FUNKSIONIMI I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Neni 13

Viti shkollor hapet me 1 tetor dhe mbaron me 30 qershor të vitit pasardhës.

Procedurat e konkursit zhvillohen gjatë muajit shtator.

Neni 14

Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë tre vjeçare që përbëhet nga:

- a) Një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;
- b) një vit praktik nën kujdesin dhe drejtimin e një gjyqtari ose prokurori me kualifikim të lartë (periudha e stazhit paraprofesional);
- c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

Programi teorik sipas gërmës a) të nenit 14 është i përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa viti praktik dhe viti i stazhit profesional zhvillohen sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror.

Drejtori i shkollës afishon listën e gjykatave dhe prokurorive, ku do të zhvillohet stazhi, magjistratët përgjegjës dhe emrat e kandidatëve për secilën gjykatë dhe prokurori.

Neni 15

Pedagogët e përhershëm dhe të jashtëm emërohen nga bordi me propozim të drejtorit sipas kriterëve të përcaktuara nga ky bord.

Paga e pedagogut është e barabartë me atë të anëtarit të gjykatës së Apelit.

Për lëndët e përgjithshme mund të aktivizohen pedagogë të jashtëm që kanë ushtruar për një kohë të gjatë detyra si gjyqtar, prokuror, avokat dhe pedagog. Për lëndët specifike aktivizohen specialistë të atyre fushave.

Pedagogët për lëndët që zhvillojnë vetë, përgatiten, si dhe ndihmohen nëpërmjet kurseve, seminarëve apo kolokiumeve që zhvillohen periodikisht.

Neni 16

Për pranimin e kandidatëve do të veprohet si vijon:

Drejtori i Shkollës, në përputhje me listën e vendeve vakant të hartuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, shpall njoftimin për paraqitjen e kërkesave të kandidatëve, duke bërë të njohur edhe dokumentet që duhet të shoqërojnë këtë kërkesë, si dhe datën e mbarimit të afatit për paraqitjen e tyre. Së bashku me njoftimin, drejtori i Shkollës bën të njohur edhe listën e lëndëve, të cilat do të shërbejnë si bazë për testimin e kandidatëve.

Kandidatët do të paraqesin këto dokumente:

- a) kopje të diplomës së juristit
- b) listë notash të shkollës së lartë
- c) një kërkesë ku të shprehet vetë dëshira e kandidatit për profilin e zgjedhur si gjyqtar ose prokuror.

Neni 17

Kandidatët i nështrohen konkursit, i cili zhvillohet me shkrim dhe me gojë para një jurie të përbërë prej pesë vetash të caktuar nga bordi i drejtimit.

Në përfundim të konkurimit nxirret lista e fituesve, e cila miratohet nga bordi i drejtimit. Kandidatët e pranuar janë të detyruar të frekuentojnë rregullisht programin dhe të respektojnë rregulloren e Shkollës.

Neni 18

Kandidatët gjatë periudhës së ndjekjes së programit marrin një shpërblim të barabartë me 50% të pagës së gjyqtarit të gjykatës së rrethit për dy vitet e para të programit.

Kandidati që përjashtohet ose largohet nga Shkolla në mënyrë të pajustificuar detyrohet të kthejë shpërblimin e marrë gjatë periudhës së ndjekjes së programit teorik dhe të stazhit paraprofesional.

Neni 19

Në përfundim të periudhës së veprimtarisë teorike si dhe të stazhit paraprofesional, kandidatët emërohen provizorisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas vlerësimit të këshillit pedagogjik. Vlerësimi bëhet në katër shkallë:

- a) pamjaftueshëm
- b) mjaftueshëm
- c) mirë
- d) shumë mirë.

Kandidatët që marrin vlerësimin pamjaftueshëm nuk i nënshtrohen procesit të emërimit provizor.

Neni 20

Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet mbi bazën e rezultateve teorike dhe stazhit praktik nga këshilli pedagogjik i formuar sipas nenit 9 pika 1 të këtij ligji.

Drejtorja e shkollës ngarkon në rrethet ku zhvillohet stazhi, gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët pasi inspektojnë punën e stazhierit paraqesin raporte vlerësimi për ta, për të ndihmuar këshillin për

vlerësimin e kandidatit.

Drejtori i Shkollës listën e fituesve ia dërgon për emërim përfundimtar Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pasi grumbullon të dhënat e nevojshme për secilin kandidat, bën emërimin përfundimtar të tyre në vendet vakante sipas shkallës së vlerësimit të tyre nga Shkolla e Magjistraturës. Kur këto vende mungojnë ata që qëndrojnë në pritje të emërimit të tyre, përfitojnë pagën dhe të drejtat e tjera të magjistratit.

Kandidati për gjyqtar në raste të tilla, me pëlqimin e tij, mund të vendoset në detyrën e ndihmësgjyqtarit ose në administratën gjyqësore, deri në krijimin e vendit vakant.

Neni 21

Gjatë periudhës së stazhit profesional kandidatët gëzojnë të drejta dhe kanë detyrime njëlloj si magjistratët.

Neni 22

Magjistratët e emëruar, që pa shkaqe të përligjura heqin dorë apo kërkojnë largimin nga detyra pa kaluar pesë vjet nga emërimi, detyrohen t'i paguajnë Shkollës së Magjistraturës një shumë të hollash që përbëhet nga shpërblimi i marrë gjatë programit teorik dhe stazhi praktik paraprofesional në proporcion me kohën e mospërbushjes së detyrimit.

Neni 23

Formimi plotësues

Gjyqtarët dhe prokurorët, që nuk kanë mbushur pesë vjet në punë dhe nuk kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, i nënshtrohen veprimtarive të vazhdueshme për formimin plotësues.

Periudha e formimit nuk duhet të kalojë më shumë se një muaj në vit dhe kurdoherë jo më shumë se tre muaj gjithsej gjatë pesë vjetëve.

Pjesëmarrja e magjistratëve në veprimtarinë e formimit plotësues është e detyrueshme.

Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të pjesëmarrësve në këto kurse përballohen nga fondet e Shkollës së Magjistraturës.

Kryetari i gjykatës së rrethit dhe prokurori i rrethit i bëjnë propozimet përkatësisht:

Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurorit të Përgjithshëm për gjyqtarët dhe prokurorët që do të ndjekin veprimtaritë për formimin plotësues. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurorit të Përgjithshëm, vendos mbi numrin dhe magjistratët që do t'i nënshtrohen këtyre veprimtarive.

Neni 24

Shkolla e Magjistraturës periodikisht organizon sesione studimore, seminare, kolokiume dhe veprimtari të tjera me qëllim që të sigurojë informacion bashkëkohor për perfeksionimin e magjistratëve.

Pjesëmarrja e magjistratëve në këto veprimtari studimore dhe shkencore është fakultative.

Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit gjatë vazhdimit të këtyre veprimtarive përballohen nga gjykata dhe prokuroritë ku janë atashuar pjesëmarrësit.

Shkolla e Magjistraturës në bashkërendim me Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën e Kasacionit, Prokurorinë e Përgjithshme dhe fakultetet e drejtësisë organizojnë kurse disa ditore me shkëputje nga puna për gjyqtarët dhe prokurorët. Procedura e përzgjedhjes është e njëjtë me atë të parashikuar në nenin e mësipërm.

Periudha dhe fusha e kualifikimit përcaktohet nga vetë magjistrati. Veprimtaritë e mësipërme nuk ndjekin qëllime skualifikimi.

Neni 25

Gjyqtarët, prokurorët dhe juristët që marrin pjesë në veprimtaritë e formimit plotësues, si dhe

në kurset e perfeksionimit, në mbarim të tyre pajisen me certifikatë të posaçme të lëshuar nga drejtori i Shkollës së Magjistraturës.

Certifikatat futen në dosje dhe dëshmojnë për kualifikimin e magjistratëve.

Neni 26

Çdo ligj dhe akt nënligjor që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të Fletores Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1581, datë 14.8.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha